

AYEN AS ENERGJI sh.a

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 30



RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionerëve të Shoqërisë Ayen AS Energji sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Ayen AS Energji sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

18 shkurt 2019



Teit Gjini
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	30,794,125,650	31,842,626,736
Garanci	7	4,126,450	4,126,450
Totali i aktiveve afatgjatë		30,798,252,100	31,846,753,186
Aktivët afatshkurtra			
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	7,748,868	2,880,047
Inventarë	9	6,685,661	2,132,309
Llogari të arkëtueshme	10	91,582,664	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11,26	420,826,490	581,990,778
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	3,085	10,487
TVSH e arkëtueshme	13	2,210,438,288	3,881,186,310
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	367,225,187	103,069,504
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,104,510,243	4,571,269,435
Totali i aktiveve		33,902,762,343	36,418,022,621
KAPITALI			
Kapitali themeltar		11,900,000,000	11,900,000,000
Reduktim i paregjistruar i kapitalit		-	-
Fitime të mbartura		(116,661,934)	(157,524,125)
Fitimi i ushtrimit		118,100,791	40,862,191
Totali i kapitalit	15	11,901,438,857	11,783,338,066
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	16	19,770,448,362	21,886,632,297
Totali i detyrimeve afatgjatë		19,770,448,362	21,886,632,297
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	16	1,172,490,000	1,595,400,000
Interesa të perlllogaritura	16	490,618,901	504,688,045
Llogari të pagueshme tregtare	17	94,032,611	295,439,134
Detyrime të tjera ndaj paleve të lidhura	18,26	453,027,683	343,518,051
Detyrim për tatimin mbi fitimin		17,877,691	6,446,246
Llogari të pagueshme të tjera	19	2,828,238	2,560,782
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,230,875,124	2,748,052,258
Totali i detyrimeve		22,001,323,486	24,634,684,555
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		33,902,762,343	36,418,022,621

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		2,309,745,563	596,632,232
Të ardhura të tjera		14,172,874	198,108
Total të ardhura	20	2,323,918,437	596,830,340
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	21	(460,278,500)	(41,569,653)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(1,613,771,472)	(480,809,813)
Shpenzime personeli	22	(117,820,035)	(100,399,145)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(134,678,298)	(87,931,138)
Total shpenzime		(2,326,548,305)	(710,709,749)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	24	(1,402,454,379)	(126,847,229)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	24	1,546,002,412	288,135,075
Fitimi/humbja para tatimit		140,918,165	47,408,437
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(22,817,374)	(6,546,246)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(22,817,374)	(6,546,246)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		118,100,791	40,862,191
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		118,100,791	40,862,191

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



AYEN AS ENERGJI sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Kapitali regjistruar i paguar	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	11,900,000,000	(166,956,557)	(126,158,352)	(31,365,773)	11,575,519,318
Fitimi/ Humbja e vitit	-	-	-	40,862,191	40,862,191
Transferim në fitime të mbartura/ humbje të akumuluar	-	-	(31,365,773)	31,365,773	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike	-	166,956,557	-	-	166,956,557
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	11,900,000,000	-	(157,524,125)	40,862,191	11,783,338,066
Fitimi/ Humbja e vitit	-	-	-	118,100,791	118,100,791
Transferim në fitime të mbartura/ humbje të akumuluar	-	-	40,862,191	(40,862,191)	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	11,900,000,000	-	(116,661,934)	118,100,791	11,901,438,857

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Ayen AS Energji sh.a dhe janë firmosur si më poshtë:

Fahrettin Amir Arman
Administrator



Pasqyra e Flukseve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	140,918,165	40,862,191
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,613,771,472	480,809,813
Diferencat e këmbimit nga aktiviteti jo operativ	(1,696,336,871)	(390,350,893)
Humbje nga shitja e AAM-ve	-	1,605,563
Interesa të maturuara	1,497,605,585	127,010,561
Ndryshimi në kapitalin qarkullues		
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(4,868,821)	402,891,617
Rënie/(rritje) në garancitë	-	-
Rënie/(rritje) në TVSH e arkëtueshme	1,670,748,022	343,034,961
Rënie/(rritje) në inventar	(4,553,352)	17,020,747
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme	69,589,026	(371,077,113)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme	(201,406,523)	(295,805,037)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme të tjera	103,200,842	175,401,403
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	3,188,667,545	531,403,813
Interesa të paguara	-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(4,809,683)	-
	(4,809,683)	-
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(565,270,386)	(2,281,289,279)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	-	905,962
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(565,270,386)	(2,280,383,317)
Aktivitetet financuese		
Kontribute nga pronarët	-	166,956,557
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë	(879,760,000)	2,655,573,447
Pagesat e kosos se huasë	(1,474,671,793)	(1,116,102,282)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(2,354,431,793)	1,706,427,722
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	264,155,683	(42,551,782)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	103,069,504	145,621,286
Mjetet monetare në fund të periudhës	367,225,187	103,069,504

14

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Ayen AS Energji sh.a. ("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqëria është regjistruar në datën 31 maj 2011 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me NIPT L11731504A dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Rruga "Papa Gjon Pali i II-te", ABA Business Center, Kati 6, Njesia Bashkiake Nr.2, Tiranë.

Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet nga 119,000 aksione me vlerë nominale LEK 100,000, për një vlerë totale LEK 11,900,000,000. Aksionerët e shoqërisë janë:

- Ayen Enerji Anonim Sirketi 82%
- AS Energy 9%
- Ayel Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi 8%
- Z. Fahrettin Amir Arman 1%

Më 31 dhjetor 2018, shoqëria ka 59 punonjës (31 dhjetor 2017: 57).

Objekti kryesor i Shoqërisë përbëhet nga planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi i tre hidrocentraleve me një kapacitet të instaluar, të kombinuar prej rreth 109.71 MW në Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fangut dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe ndonjë veprimtari tjetër biznesi të lejuara që janë të nevojshme apo të dobishme për të përmbushur objektivin e saj.

Marrëveshja e Konçesionit dhe ndryshimet – terma të rëndësishëm

Sipas:

- Nenet 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë;
- Ligjit shqiptar Nr. 9663 "Për konçesionet" i datës 18 dhjetor 2006;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 147 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien e konçesion të kaskadës së hidrocentraleve në lumin Fan i Vogël dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet Shoqërisë" më datë 11 shtator 2011;
- Kontratës së konçesionit rep nr. 5446, col nr. 1944, më datë 2 maj 2011 të aprovuar nga Vendimi Nr. 365 më datë 5 maj 2011, i cili hyri në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 62 më datë 23 maj 2011.
- Kontratë konçesionit shtese e aprovuar nga Vendimi Nr.442 më datë 22 Maj 2013
- Kontratë konçesionit shtese e aprovuar me Vendimin Nr. 51 më datë 25.01.2017, e cila hyri në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare më datë 2 Shkurt 2017.

Sipas Marrëveshjes së Konçesionit, Shoqëria konçesionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga konçesionari). Marrëveshja e Konçesionit përbën një model projekti i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 41 vjetësh(35 vjet me një zgjatje prej 6 vitesh e aprovuar nga vendimi Nr. 442 më datë 22 Maj 2013) me të drejtë zgjatjeje automatike pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Konçesionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat dhe kontratat. Konçesionari do të ndërtojë tre Hidrocentrale: "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu"(siç specifikohet në shtesën e kontratës së konçesionit aprovuar nga vendimi Nr. 51 më datë (25.01.2017) me një kapacitet total të instaluar prej 109.71 MW. Investimi total është 210,184,740 Euro (siç specifikohet në shtesën e kontratës së konçesionit aprovuar nga vendimi Nr.51 më datë 25.01.2017)



2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.



3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i IFRS 9 "Instrumentat Financiare"

Shoqëria ka adoptuar IFRS 9, Instrumentat Financiar, nga 1 janar 2018. Kompania zgjodhi të mos rishikojë shifrat krahasuese dhe ka njohur çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve financiare në fitimet e mbartura të hapura që nga data e zbatimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Si rrjedhojë, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentat Financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese është zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato informacione shpjeguese të bëra në vitin paraardhës.

Adoptimi i IFRS 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"

Shoqëria vendosi të aplikojë metodën e thjeshtëzuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetet praktike të disponueshme për këtë kalim. Kompania aplikon IFRS 15 vetëm për kontratat që nuk ishin plotësuar deri më datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018).

Adoptimi i IFRS 15 nuk rezulton në korrigjime të pasqyrave financiare për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Kontabiliteti për modifikimin e kontratës: Kompania nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratës për shkak të natyrës së kontratës ose shumave të arkëtueshme.
- Detyrime të performancës shtesë të identifikuar: Kompania siguron vetëm një detyrim për performance të veçantë, shitjen e energjisë.
- Kontabilizimi për komponentë të rëndësishëm të financimit: Kompania nuk ka kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti e tejkalon një vit.
- Kontabiliteti për programet e besnikërisë së klientit: Kompania nuk ka ndonjë program besnikërie apo nxitjeje të konsumatorëve.
- Ndryshimet në kohën e njohjes së të ardhurave (nga përgjatë kohës në një pikë në kohë ose anasjelltas): Të ardhurat nga shitja e energjisë njihen në periudhën kontabël në të cilën transmetohet energjia. Koha e njohjes së të ardhurave mbetet e ngjashme me SNK 18.
- Kontabilizimi për rimbursimet: Kompania nuk zbaton rimbursime.
- Kontabilizimi për kostot e marrjes së kontratës: Shoqëria nuk ka ndonjë kosto për të marrë një kontratë.
- Kontabilizimi për kostot e realizimit të kontratës: Shoqëria nuk ka asnjë kosto për të përmbushur një kontratë.
- Paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës: Aplikimi i SNRF 15 nuk ka ndonjë ndikim në Shoqëri që do të çonte në njohjen e një aktivi apo detyrime të kontratës.

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në shoqëri:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësi ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).



3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon të aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nëfjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka vendosur zbatimin e standardit nga data e saj e adoptimit të detyrueshëm, data 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shifrave krahasuese.

Tabela në vijim paraqet një rakordim të angazhimeve të qirasë operative në Shënimin 27 të detyrimit të njohur:

	31 dhjetor 2018 / 1 janar 2019
Pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operationale që nuk mund të anulohen (Shënimi 27)	10,707,919
- Pagesat e ardhshme të qirasë që duhet të paguhen në periudhat që u nënshtrohen opsioneve të shtrirjes së qirasë që janë të arsyeshme për t'u ushtruar	9,987,083
- Pagesat e ardhshme me pagesa qiraje të ndryshueshme që bazohen në një indeks ose një normë	-
- Efekti i skontimit në vlerën aktuale	720,836
Detyrimet totale të qirasë	

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).



4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR / LEK	123.42	132.95
USD / LEK	107.82	111.10
GBP / LEK	137.42	149.95

4.2 Instrumenta financiarë

Politika të aplikueshme nga 1 janar 2018

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.



4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimin 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çylerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.



4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Politika të aplikueshme para 1 janar 2018

Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë të arkëtueshmet e tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, për shkak të detyrimeve dhe detyrimeve të tjera.

Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit shkojnë direkt në pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve të mjeteve monetare nga aktivet financiare mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare trajtohen në datën e tregtimit, dmth. Datën që Kompania angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Kompanisë të specifikuar në kontratë përfundojnë ose shkarkohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) *Kostot vijuese*

Kostojat e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostojat mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Toka	Nuk amortizohet
Ndërtesa, makineritë dhe paisjet e Hidrocentralit	5%
Kontenier	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivelesohen në çdo datë raportimi.

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.



4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.6 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

4.7 Pagesat e qirasë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.9 Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumën e mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.10 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Aktivitetet më të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

4.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12 Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit mbi fitimin të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit mbi fitimin në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.



5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivitar financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezultojnë nga shkeljet e kriterëve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivitar financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezultojnë nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogaritet koston e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.



AYEN AS ENERGJI sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale janë detajuar si mëposhtë:

<i>Kosta</i>	Toka	Përmirësim e të tokës	Ndërtesa	Kontenier	Hydrocentrali	Makinieri	Automjete	IT dhe Pajisje Komputerike	Pajisje zyre	Punime në Proces	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	2,960,000	4,666,141,200	739,978,120	1,664,691	-	2,394,864,704	83,561,445	5,365,480	22,381,547	21,724,983,981	29,661,901,168
Shtesa	-	-	-	-	-	3,014,423	3,022,346	1,058,259	181,480	3,359,084,333	3,366,360,841
Transferime	(2,960,000)	(4,666,141,200)	(739,978,120)	-	-	(2,367,843,940)	-	-	-	(25,084,068,314)	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-	(7,309,232)	-	-	-	(7,309,232)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-	1,664,691	32,860,991,574	30,035,187	79,274,559	6,423,739	22,563,027	-	33,000,952,777
Shtesa	-	-	-	-	536,749,943	237,715	3,513,592	584,987	24,184,149	-	565,270,386
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	1,664,691	33,397,741,517	30,272,902	82,788,151	7,008,726	46,747,176	-	33,566,223,163
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>											
Gjendja më 1 janar 2017	-	381,068,198	60,431,546	599,289	-	206,314,445	21,768,487	2,028,441	10,103,529	-	682,313,935
Amortizimi i vitit	-	-	-	213,080	461,484,418	2,925,870	12,601,280	857,535	2,727,630	-	480,809,813
Riklasifikime	-	(381,068,198)	(60,431,546)	-	-	(193,373,922)	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-	(4,797,707)	-	-	-	(4,797,707)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-	812,369	1,096,358,084	15,866,393	29,572,060	2,885,976	12,831,159	-	1,158,326,041
Amortizimi i vitit	-	-	-	170,464	1,597,447,271	2,859,182	10,291,859	967,792	2,034,904	-	1,613,771,472
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	982,833	2,693,805,355	18,725,575	39,863,919	3,853,768	14,866,063	-	2,772,097,513
<i>Vlera neto kontabël</i>											
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-	-	852,322	31,764,633,490	14,168,794	49,702,499	3,537,763	9,731,868	-	31,842,626,736
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	681,858	30,703,936,162	11,547,327	42,924,232	3,154,958	31,881,113	-	30,794,125,650



(Vlerat janë në Lek)

6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Ndërtimi i tre hidrocentraleve të Peshqeshit përfundoi më 4 maj 2015. Kapaciteti i instaluar dhe kapaciteti vjetor për prodhimin është 34MW dhe 118.400.000 kWh respektivisht. Ndërtimi i hidrocentralit Ura Fanit dhe Fangut përfundoi më 30 nëntor 2017.

7. Garanci

Balanca e garancisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Garanci financiare	4,126,450	4,126,450
	<u>4,126,450</u>	<u>4,126,450</u>

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Balanca e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Parapagime ndaj furnitorëve	30,000	29,975
Shpenzime të shtyra	7,718,868	2,850,072
	<u>7,748,868</u>	<u>2,880,047</u>

9. Inventari

Balanca e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Lendë e pare	6,685,661	2,132,309
	<u>6,685,661</u>	<u>2,132,309</u>

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	88,265,925	-
Klientë për fatura të pambërritura	3,316,739	-
	<u>91,582,664</u>	<u>-</u>



11. Llogari të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të arkëtueshme tregtare nga palë të lidhura	363,665,504	581,990,778
Llogari të tjera të arkëtueshme nga palë të lidhura	57,160,986	-
	<u>420,826,490</u>	<u>581,990,778</u>

12. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogarive të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të tjera të arkëtueshme	3,085	-
Paradhënie për punonjësit	-	10,487
	<u>3,085</u>	<u>10,487</u>

13. Tvsh e arkëtueshme

Balanca e TVSH-së së arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
TVSH e arkëtueshme	52,996,474	273,744,496
TVSH e aprovuar për rimbursim	2,157,441,814	3,607,441,814
	<u>2,210,438,288</u>	<u>3,881,186,310</u>

Balanca e TVSH-së së arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 është 2,210,438,288 Lek (2017: 3,881,186,310 Lek). Raporti i kontrollit tatimor. Gjatë vitit 2018, kompania ka marrë rimbursime në shumën 1,450,000,000 Lek. Balanca e TVSH-së së aprovuar për rimbursim është 2,157,441,814 Lek.

14. Mjete monetare në arkë dhe bankë

Mjetet dhe ekuivalentët e saj përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Banka	359,816,446	96,865,387
<i>Banka në LEK</i>	<i>2,150,685</i>	<i>56,320,648</i>
<i>Banka në EUR</i>	<i>357,581,478</i>	<i>40,457,892</i>
<i>Banka në USD</i>	<i>84,283</i>	<i>86,847</i>
Arka	7,408,741	6,204,117
<i>Arka në LEK</i>	<i>2,948,219</i>	<i>6,204,117</i>
<i>Arka në EUR</i>	<i>4,460,522</i>	<i>-</i>
	<i>-</i>	<i>-</i>
Likuiditete në Udhëtim	-	-
	<u>367,225,187</u>	<u>103,069,504</u>



15. Kapitali aksionar

Numri dhe vlera nominale e aksioneve të regjistruara më 31 dhjetor 2018

Më 31 dhjetor 2018 kapitali aksionar i regjistruar i shoqërisë është 11,900,000,000 LEK (2017: 11,900,000,000 LEK) i ndarë në 119,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale secila prej 100,000 LEK.

Struktura e Aksionerëve

Tabela e mëposhtme tregon aksionerët e Shoqërisë mbajtës të aksioneve më 31 dhjetor 2018 së bashku me numrin dhe përqindjen e aksioneve totale të emetuara:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Numër aksionesh	% e kapitalit	Numër aksionesh	% e kapitalit
Fahrettin Amir Arman	1,190	1%	1,190	1%
AS ENERGY	10,710	9%	10,710	9%
AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI	97,580	82%	97,580	82%
Ayel Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi	9,520	8%	9,520	8%
Total	119,000	100%	119,000	100%

16. Hua afatgjata

Shoqëria ka firmosur një kontratë huaje me Is Bank me vlerë 128 milion Euro më 26 shkurt 2014. Kjo kontratë u ndryshua më 31 korrik 2015 dhe shuma e huasë u rrit në 158 milion Euro. Kontrata e kredisë u ndryshua më 24 Nentor 2016 dhe shuma e kredisë u rrit në 178 milion Euro.

Më 31 dhjetor 2018, shoqëria ka përdorur 178 milion Euro (më 31 dhjetor 2017: 178 milion Euro). Huaja është e disponueshme që prej datës 20 gusht 2013 dhe do të perfundojë më 20 gusht 2030. Bazuar në kontratë, shoqëria ka paguar një tarifë për nënshkrimin e marrëveshjes në datën e nënshkrimit dhe do të paguajë një tarifë angazhimi e pagueshme në çdo datë të pagimit të interesit. Huaja sigurohet me format e kolateralit në vijim: garantor, sigurim mbi pasuritë e luajtshme, kontratë pengu mbi të arkëtueshmet, kontratë pengu mbi aksionet, kontrata hipotekore. Gjatë vitit 2018, shoqëria ka paguar 7 milion Euro principal të huasë.

Shuma e interesit e periudhës është përfshirë në shpenzimet e periudhës Shpenzimi i interesit i kapitalizuar në punime në proces për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 ishte 1.133.726.963 LEK.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Hua nga IS BANK	20,942,938,362	23,482,032,297
Detyrime të konstatuara të lidhura me huanë	490,618,901	504,688,045
	21,433,557,263	23,986,720,342

17. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë të përbëra si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë për fatura të pambërritura	816,295	31,844
Llogari të pagueshme	93,216,316	295,407,290
	94,032,611	295,439,134



18. Llogari të tjera ndaj palëve të lidhura

Balanca e llogarive të tjera të pagueshme ndaj palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	293,202,835	171,352,166
Llogari të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	159,824,848	172,165,885
	453,027,683	343,518,051

19. Llogari të tjera të pagueshme

Balanca e llogarive të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,385,050	1,180,400
Tatim mbi të ardhurat personale	1,258,951	1,095,048
Paga të pagueshme	114,585	-
Tatimi në burim	-	149,642
Të tjera të pagueshme	-	48,523
Detyrime të tjera	69,652	87,169
	2,828,238	2,560,782

20. Të ardhura

Ndërtimi i hidrocentralit të Peshqeshit ka përfunduar dhe ka filluar të prodhojë energji prej datës 4 maj 2015 dhe ndërtimi i hidrocentralit Ura e Fanit dhe Fangu ka përfunduar dhe ka filluar të prodhojë energji prej datës 1 dhjetor 2017.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shitja e energjisë	2,309,745,563	596,632,232
Shitje të tjera	14,172,874	198,108
	2,323,918,437	596,830,340

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në jepet si mëposhtë:

	31 dhjetor 2018
Qarkullim i tatueshëm	2,320,038,230
Minus faturat e deklaruar 2 herë	(1,444,335)
Minus faturat e deklaruar me vlerë më të lartë se kontabiliteti	(203,834)
Minus faturat e deklaruar me minus të klasifikuar si shpenzime	2,211,636
Shuma e qarkullimit e korrektuar	2,320,601,697
<i>Sipas kontabilitetit</i>	
Të ardhura	2,309,745,563
Të ardhura të tjera	14,172,874
Minus të ardhurat e regjistruara pa marrë faturë	(3,316,740)
Të ardhura nga shitja e automjeteve që janë paraqitur neto me vlerën kontabël neto të AAM-ve të shitura	-
	2,320,601,697
Diferenca	-



21. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime mirëmbajtje	162,573,819	38,393,417
Blerje e energjisë	236,883,090	-
Shpenzime të konsulencës teknike	48,442,458	-
Shpenzime transporti	1,202,480	79,672
Disbalana dhe tarifë transmetimi	11,086,653	3,096,564
Shpenzime të tjera	90,000	-
	460,278,500	41,569,653

22. Shpenzime personeli

Balanca e shpenzimeve të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga dhe shpërblimet e personelit	107,967,358	91,906,094
Sigurime shoqërore e shëndetësore	9,852,677	8,493,051
	117,820,035	100,399,145

23. Shpenzime operative

Balanca e shpenzimeve operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Qira	8,479,284	5,051,769
Shërbime ligjore	5,403,508	10,121,985
Shpenzime të tjera për personelin	7,445,974	9,107,339
Shpenzime kanceleri	301,980	627,823
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,742,366	3,027,148
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	344,350	99,232
Shpenzime uji dhe elektriciteti	10,871,884	3,249,381
Shpenzime bankare	1,351,537	1,664,245
Shpenzime sigurie	52,235,233	13,159,396
Taksa	7,860,029	2,437,770
Shërbime kontabiliteti dhe auditimi	3,424,687	3,056,179
Konsulencë	17,231,272	25,749,807
Gjoba dhe dëmshpërblime	199,084	15,590
Blerje karburanti	7,391,454	2,986,256
Humbje nga AQ të shitura	-	1,605,563
Shpenzime të tjera	9,395,656	5,971,655
	134,678,298	87,931,138



AYEN AS ENERGJI sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime operative (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga shitja e AAM	-	905,962
Shpenzime nga shitja e AAM	-	(2,511,525)
		(1,605,563)

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesat	3,847	163,332
Shpenzime për interesat	(1,402,458,226)	(127,010,561)
Shpenzime financiare të tjera	(95,147,359)	(107,205,410)
Humbje nga këmbimet valutore	(104,057,118)	(75,568,225)
Të ardhura nga këmbimet valutore	1,745,206,889	470,908,710
	143,548,033	161,287,846

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit llogaritet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	140,918,165	47,408,437
<i>Total shpenzime të panjohura</i>	11,197,661	13,307,341
Gjoha dhe kompesime	199,084	15,590
Humbje nga AQ të shitura	-	1,605,563
Shpenzime të tjera	10,998,577	11,686,188
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	152,115,826	60,715,778
Humbje fiskale e mbartur	-	(17,074,139)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	22,817,374	6,546,246
Humbje fiskale e mbartur nga vitet e mëparshme	118,100,791	40,862,191



AYEN AS ENERGJI sh.a
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

26. Palët e lidhura

Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018		31 Dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Metay Insaat SANAYI VE TICARET A.S	-	-	-	18,523,131
AS Energy Shpk	37,839,585	-	-	-
Aydiner Anonim Sirketi Tirana Branch	-	224,910,444	-	126,966,091
AYEN ENERGY TRADING SH.A	373,730,405	8,095,085	581,990,778	-
AYEN TRADING BEOGRAD	1,851,300	-	-	-
AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI	-	177,324,285	-	198,028,829
Koncesionari AYEN ALB	7,405,200	-	-	-
Ayen Elektrik Ticaret AS	-	42,697,869	-	-
	420,826,490	453,027,683	581,990,778	343,518,051

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ayen Enerji Anonim Sirketi	-	17,499,437	-	25,870,052
Metay Insaat SANAYI VE TICARET A.S	-	-	-	66,282,166
Aydiner Anonim Sirketi Tirana Branch	-	564,333,750	-	1,323,705,882
AYEN TRADING BEOGRAD	236,131,511	113,469,685	-	-
AYEN ENERGY TRADING SH.A	1,775,427,620	92,482,355	596,632,232	3,409,215
Ayen Elektrik Ticaret AS	-	42,697,870	-	-
	2,011,559,131	830,483,097	596,632,232	1,419,267,315

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Përfitimet e drejtimit dhe menaxhimit	22,201,680	22,197,224
	22,201,680	22,197,224



27. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë. Politikat e manaximit të riskut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

	31 dhjetor 2018			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	524,239,043	41,169,670	2,157,441,814	2,722,850,527
Mjete monetare në arkë dhe bankë	367,225,187	-	-	367,225,187
Totali	891,464,230	41,169,670	2,157,441,814	3,090,075,714

	31 dhjetor 2017			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	416,061,541	403,690,619	3,643,435,415	4,463,187,575
Mjete monetare në arkë dhe bankë	103,069,504	-	-	103,069,504
Totali	519,131,045	403,690,619	3,643,435,415	4,566,257,079

Nuk ka tregues zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera aktive financiare në datën e raportimit.



27. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdimi)

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuïdohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të kompanisë.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2018 dhe më 31 dhjetor 2017.

Përshkrimi	31 dhjetor 2018			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare dhe të tjera të arkëtueshme	2,722,850,527	-	-	2,722,850,527
Mjete monetare në arkë dhe bankë	367,225,187	-	-	367,225,187
Totali	3,090,075,714	-	-	3,090,075,714
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(567,766,223)			(567,766,223)
Hua	(1,076,863,901)	(586,245,000)	(19,770,448,362)	(21,433,557,263)
Totali	(1,644,630,124)	(586,245,000)	(19,770,448,362)	(22,001,323,486)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	1,445,445,590	(586,245,000)	(19,770,448,362)	(18,911,247,772)

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Total
Llogari tregtare dhe të tjera të arkëtueshme	4,463,187,575	-	-	4,463,187,575
Mjete monetare në arkë dhe bankë	103,069,504			103,069,504
Totali	4,566,257,079	-	-	4,566,257,079
Llogari tregtare dhe të tjera të pagueshme	(641,517,967)	-	-	(641,517,967)
Hua	(504,688,045)	(1,595,400,000)	(21,886,632,297)	(23,986,720,342)
Totali	(1,146,206,012)	(1,595,400,000)	(21,886,632,297)	(24,628,238,309)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	3,420,051,067	(1,595,400,000)	(21,886,632,297)	(20,061,981,230)



27. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdimi)

(c) Risku i valutës

Ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2018 dhe më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2018			
	EURO	LEK	Të tjera	Total
Llogari tregtare dhe të tjera të arkëtueshme	496,053,032	2,226,797,495	-	2,722,850,527
Mjete monetare në arkë dhe bankë	362,042,000	5,098,904	84,283	367,225,187
Totali	858,095,032	2,231,896,399	84,283	3,090,075,714
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	507,981,190	50,899,117	8,885,916	567,766,223
Hua	21,433,557,263	-	-	21,433,557,263
Totali	21,941,538,453	50,899,117	8,885,916	22,001,323,486
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	22,799,633,485	2,282,795,516	8,970,199	25,091,399,200

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	EURO	LEK	Të tjera	Total
Llogari tregtare dhe të tjera të arkëtueshme	581,990,778	3,881,196,797	-	4,463,187,575
Mjete monetare në arkë dhe bankë	40,457,892	62,524,765	86,847	103,069,504
Totali	622,448,670	3,943,721,562	86,847	4,566,257,079
Llogari tregtare dhe të tjera të pagueshme	625,371,022	8,233,713	7,913,232	641,517,967
Hua	23,986,720,342	-	-	23,986,720,342
Totali	24,612,091,364	8,233,713	7,913,232	24,628,238,309
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017	25,234,540,034	3,951,955,275	8,000,079	29,194,495,388

(d) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohen se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivitetet dhe detyrimet e shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Në datën e raportit, instrumentat financiarë mbartës të normave të interesit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Huamarrje afatgjatë	20,942,938,362	23,482,032,297
Detyrime të konstatuara të lidhura me huanë	490,618,901	504,688,045
	21,433,557,263	23,986,720,342



28. Angazhime dhe pasiguri*Angazhime për qiranë operative*

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte kontrata qiraje operative lidhur me qiranë e zyrave në Tiranë dhe terren dhe apartamenteve. Pagesat e ardhshme minimale të qirasë në bazë të kontratës janë si vijon:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Brënda një viti	3,569,306	3,524,505
Pas një viti por jo më shumë se pesë vite	6,841,171	-
	<u>10,410,477</u>	<u>3,524,505</u>

Garancia e kontratës

Duke iu referuar nenit 14 të Marrëveshjes së Konçesionit "Garancia e Kontratës", Kompania ka paraqitur një Kontratë Garancie. Kontrata e garancisë në favor të Autoritetit Kontraktues (METE) e lëshuar nga shoqëria mëmë Ayen Enerji Anonim Sirketi, me një shumë prej 680 milion Lek, përpara nënshkrimit të Kontratës së Konçesionit. Kjo shumë ishte ndryshuar në shtesën e kontratës së konçesionit të aprovuar nga vendimi Nr. 51 më datë 25.01.2017 në 10,509,237 Euro. Koncesionarit i lejohet të ç'ngurtësojë këtë vlerë, bazuar në parashikimet e nenit 11, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë. Kontrata e sigurimit do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Konçesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe do të ç'ngurtësohet totalisht me përfundimin e testimit.

Angazhimete kapitalit sipas Marrëveshjes Konçesionare dhe Amendimit të Marrëveshjes

Bazuar në Shtesën e Kontratës Konçesionareaprovuar nga vendimi Nr.51 më datë25.01.2017, shoqëria është përgjegjëse për planifikimin, financimin, ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e 3 hidrocentraeve në Peshqesh, Ura e Fanit, and Fangu. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga shoqëria është në vlerën 210,184,740 Euro. Ndërtimi ka përfunduar në dhjetor 2017.

29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

